



Në bazë të Programit për aktivitetet në fushën e mbrojtjes sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore, në Qytetin e Shkupit ("Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit" numër 14/25 dhe numër 02/26), Qyteti i Shkupit shpall:

THIRRJE PUBLIKE
për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të sendit të paluajtshëm,
pronësi e Qytetit të Shkupit

I. Lënda e Thirrjes publike:

Lënda e thirrjes publike është dhënia e së drejtës së shfrytëzimit të përkohshëm të sendit të paluajtshëm - pesë lokale, në rr. "Sava Kovaçeviq" nr. 1, lamela 2 dhe lamela 3, PK 794/1 KK Kisela Voda, pronësi e Qytetit të Shkupit, një shoqate qytetarësh ose fondacioni që punon në fushën e promovimit të zgjidhjeve për krijimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse nëpërmjet formimit të klubeve sociale për kategori të ndryshme të qytetarëve në nevojë me qëllim përfshirjen e tyre sociale (fëmijë me paralizë cerebrale, qytetarë me diabet dhe sëmundje të rralla), pronësi e Qytetit të Shkupit, si vijon:

- Lokali 1 - me sipërfaqe të përgjithshme 29 m²- lamela 2
- Lokali 2 - me sipërfaqe të përgjithshme 22 m²- lamela 2
- Lokali 3 - me sipërfaqe të përgjithshme 25m² - lamela 3
- Lokali 4 - me sipërfaqe të përgjithshme 47 m² - lamela 2
- Lokali 5 - me sipërfaqe të përgjithshme 29 m² - lamela 2

II. Korniza kohore për shfrytëzimin e sendit të paluajtshëm

Sendi i paluajtshëm - lokal/lokale, do të ndahen për shfrytëzim të përkohshëm pa kompensim, gjë që do të rregullohet me nënshkrimin e kontratës.

III.Kushte për pjesëmarrje në Thirrjen publike

Aplikantët që marrin pjesë në këtë Thirrje publike duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- Të jenë regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- Të punojnë në fushën e promovimit të zgjidhjeve për krijimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse nëpërmjet krijimit të serviseve, klubeve sociale dhe shërbimeve për kategori të ndryshme të qytetarëve në nevojë me qëllim përfshirjen e tyre sociale (fëmijë me paralizë cerebrale, qytetarë me diabet dhe sëmundje të rralla);
- Të kenë të paktën pesë vjet përvojë në fushën e mbrojtjes sociale;

- Të drejtojnë shërbim të specializuar për ndërtimin e komunitetit ku të gjithë ndihen të pranuar, të dëgjuar dhe aktivë;
- Të kenë përvojë në sigurimin e hapësirave të sigurta për lidhjen e njerëzve të moshave, kulturave, etnive të ndryshme, personave me aftësi të kufizuara dhe grupeve të njerëzve me sëmundje të ndryshme (persona me diabet dhe sëmundje të rralla)
- Të planifikojnë mjete nga buxheti i tyre për të paguar shpenzimet komunale në lokalet që do t'u ndahen atyre.

IV. Mënyra e aplikimit për Thirrjen publike

Aplikantët që marrin pjesë në këtë Thirrje publike duhet të depozitojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formulari i plotësuar për propozim-projektin (në dispozicion në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk);
- Aktvendimi për regjistrimin e aplikantit i lëshuar nga Regjistri Qendror;
- Fotokopje e llogarisë përfundimtare për vitin fiskal të kaluar;
- Kopje e Statutit të aplikantit;
- Certifikatë për tatime të paguara e lëshuar nga organet tatimore.

Aplikantët mund të depozitojnë dokumentacionin shtesë të mëposhtëm, i cili do të konsiderohet si përparësi:

- Biografi profesionale e ekspertëve që do të angazhohen në realizimin e projektit;
- Listë referencash ose dëshmi (shembull: kontratë e nënshkruar) për të paktën 2 projekte të realizuara në fushën për të cilën aplikohet;
- Të paktën 2 opinione (referenca) nga partnerë ose donatorë për realizimin e projekteve të mëparshme;
- Mbështetje me shkrim nga organizata dhe/ose institucione të tjera që janë planifikuar të marrin pjesë në realizimin e projektit.

V. Mënyra e zbatimit të Thirrjes publike

Për të përcaktuar përmbushjen e kushteve dhe plotësinë e dokumentacionit të depozituar për Thirrjen publike, kryetari i Qytetit të Shkupit formon Komision për zbatimin e Thirrjes publike për dhënien e së drejtës së shfrytëzimit të përkohshëm të sendit të paluajtshëm – lokal/lokale, pronësi e Qytetit të Shkupit (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni).

Aplikimet e depozituara jo në kohë, të parregullta (të palexueshme) ose të paplota dhe që nuk i plotësojnë kushtet Komisioni nuk do t'i shqyrtojë, gjë për të cilën do të informojë aplikantët aplikimet e të cilëve janë refuzuar.

Për aplikimet e plota, të depozituara në kohë dhe që plotësojnë kushtet, Komisioni depoziton propozim pranë kryetarit të Qytetit të Shkupit për zgjedhjen e aplikantit për dhënien e së drejtës së shfrytëzimit të përkohshëm të sendit të paluajtshëm - lokal/lokale.

Kryetari i Qytetit të Shkupit, me propozim të Komisionit, miraton Aktvendim për dhënien e së drejtës së shfrytëzimit të përkohshëm të sendit të paluajtshëm -

lokal/lokale aplikantëve të renditur më të mirë. Qyteti i Shkupit do të lidhë kontratë me aplikantët e përzgjedhur, me të cilën do të rregullohen të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të palëve kontraktuese në bazë të shfrytëzimit të sendit të paluajtshëm - lokal/lokale në pronësi të Qytetit të Shkupit.

VI. Afati dhe mënyra e depozitimit të aplikimeve

Afati i fundit për depozitimin e aplikimeve është 07.03.2026, deri në orën 15:00.

Aplikimi me të gjithë dokumentacionin duhet të depozitohet në Arkivin e Qytetit të Shkupit (bul. Ilinden 82, Shkup) në zarf të mbyllur me shënimin: Për Komisionin për zbatimin e Thirrjes publike për dhënien e së drejtës së shfrytëzimit të përkohshëm të sendit të paluajtshëm - lokal/lokale.

Aplikimet e depozituara nëpërmjet adresës e-mail nuk do të shqyrtohen.

Formulari i propozimit të projektit është në dispozicion në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit. www.skopje.gov.mk.

Pjesëmarrësit në Thirrjen publike do të njoftohen për rezultatet brenda 5 ditëve nga data e miratimit të Aktvendimit për dhënien e sendit të paluajtshëm - lokal/lokale.

Për informacione shtesë:

Pyetjet për sqarime mund të depozitohen me shkrim ose në mënyrë elektronike pranë Seksionit për mbrojtje sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore.

Kontakt: Seksioni për mbrojtje sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore, tel: 02/ 3297 278 dhe 02/ 3297 321 ;Adresa E-mail: socijala@skopje.gov.mk.